

KONKURRUI MI PËR NË KLASA TË POSACME

Kur nxënësi del në klasë të tretë, ai/ajo mund të konkurrojë për në klasë të posaçme ose për drejtim të posaçëm.

Nëse dëshiron të konkurrojë, duhet plotësuar aplikacioni (kërkesa) në Wilma.

Formulari i aplikimit gjendet në faqen „hakemukset ja päätökset“ (kërkesat dhe vendimet).

Apliko **më së voni deri të hënën më 15.1.2024.**

Nxënësi mund të konkurrojë **vetëm në një shkollë të klasës së posaçme.**

Në shkollën në Puolala janë dy klasë të posaçme, klasat e muzikës dhe klasat gjuhësore, dhe nxënësi mund të konkurrojë në të dy klasat e posaçme. Shkruaj alternativa 2 e aplikimit te rubrika „Lisätietoja“ (të dhëna shtesë).

Në Turku mund të konkurrohet në këto klasë dhe drejtime të posaçme:

Klasa e artit figurativ

Njësia Martti në shkollën Luostarivuoren koulu, Hopeasepänkuja 2

Takim informativ: e mërkurë 10.1.2024 në ora 18:00, <https://blog.edu.turku.fi/luostarivuori/>

Dita e testimit: e enjte 8.2.2024 ora 9.00–13.00, ftesë e veçantë nuk dërgohet.

Klasa e artit figurativ në njësinë Martti në shkollën Luostarivuori, Hopeasepänkuja 2

Të dhëna shtesë: ndihmësdrejtori Juha Mäenpää, juha.maenpaa@edu.turku.fi, tel. 044 9074 631

Drejtimi i fizkulturës

Vasaramäen koulu, Lehmustie 7

Takim informativ: e mërkurë 10.1.2024 në ora 18:00, <https://blog.edu.turku.fi/vasaramaki/>

Dita e testimit: e premte 26.1.2024 ora 9.00–11.30, ftesë e veçantë nuk dërgohet.

Pjesa e pasme e tribunës së hallës sportive të Kupittaas, Kupittaankuja 1

Të dhëna shtesë: ndihmësdrejtoresha Miina Orell, miina.orell@edu.turku.fi, tel. 040 5285 215

Drejtimi matematikor

Raunistulan koulu, Oikotie 1

Takim informativ: e martë 9.1.2024 në ora 18:00, <https://blog.edu.turku.fi/raunistula/>

Dita e testimit: e enjte 1.2.2024 në ora 13.00, ftesa e veçantë vjen me postë.

Raunistulan koulu, Oikotie 1

Të dhëna shtesë: drejtoresha Annamari Tulla, annamari.tulla@edu.turku.fi, tel.040 1292 435

Klasa e muzikës

Puolalan koulu, Kauppiaskatu 14

Takim informativ: e mërkurë 10.1.2024 në ora 18:00, <https://blog.edu.turku.fi/puolala/>

Dita e testimit: e martë 6.2. - e enjte 8.2.2024, ftesa e veçantë vjen me postë.

Puolalan koulu, Kauppiaskatu 14

Të dhëna shtesë: ndihmësdrejtoresha Kaisu Metsä-Tokila, kaisu.metsa-tokila@edu.turku.fi, tel. 050 4323 640

Plotësimi i klasave gjuhësore

Në klasë të parë fillojnë klasat gjuhësore të anglishtes, gjermanishtes dhe frëngjishtes, klasa finlandisht-rusisht si dhe klasa e dushit gjuhësor të suedishtes.

Në klasë të tretë mund të pranohen nxënës tjerë nëse ka vend të lirë në klasë.

Pyesni së pari drejtorin e shkollës se a ka vende të lira në klasat gjuhësore.

- Klasat gjuhësore të anglishtes dhe gjermanishtes, klasat finlandisht-rusisht, shkolla Puolala: ndihmësdrejtoresha Kaisu Metsä-Tokila, kaisu.metsa-tokila@edu.turku.fi, tel. 050 4323 640
- Klasat gjuhësore të frëngjishtes, shkolla Vähä-Heikkilä: zëvendësdrejtoresha Jutta Maunula-Aaltonen, tel. 040 6469 345
- Klasat e dushit gjuhësor të suedishtes, njësia Martti e shkollës Luostarivuori: ndihmësdrejtori Juha Mäenpää, juha.maenpaa@edu.turku.fi, tel. 044 9074 631

Testet për plotësimin e klasave gjuhësore do të mbahen të premten më 9.2.2024 në ora 9.00 -11.00.

Tommi Tuominen
Drejtore i shërbimeve të fushës së arsimit fillor